



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 206/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në shenjat publike të trafikut, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Kaçanik i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 800 (tetëqind ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 08.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se anëtarë të subjektit politik PDK tek Fusha e Pajtimit në Kaçanik, kanë vendosur posterë të kandidatit të tyre në tabelat publike të trafikut. Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë rast është bërë shkelje e Nenit 33 pika b) e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LQP dhe nenit 3 pika b) e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike të cilat ndalojnë vendosjen e posterëve në shenjat publike të trafikut. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 10.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 10.10.2013, në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV janë të pa bazuara lidhur me shkeljen e rregullave të përcaktuara në nenin 33 pika b) të LQP-së ose neni 3 pika b) e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike. Po ashtu në përgjigjen në ankesë theksohet se fotografit e deponuara nga pretenduesi nuk shihet qartë se ku janë të vendosura këto simbolet të PDK-së, a janë të vendosura në tabelat publike dhe se ky fakt ilustron edhe me vet pamjen e tabelës që nuk ka asnjë shenjë të trafikut dhe se në atë tabelë ka postime dhe reklama të firmave tjera thuhet në përgjigjen në ankesë nga PDK.

PDK kërkoj nga PZAP-i që ta hedhë poshtë këtë pretendim të LVV.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkrësat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit Besim Ilazi për kryetar të komunës nga radhët e PDK-së është janë vendosur në shenjat e komunikacionit, që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalojnë vendosjen e pllakateve , posterave dhe njoftimeve në shenjat publike të trafikut .

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se , ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe faktin se posterat e kandidatit për kryetar komune në Kaçanik kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e posterave. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori se PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes, duke i larguar menjëherë fotografit nga vendi ku pretendohet se ka ndodhur shkelja e supozuar

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDK-së është shkelur neni 4 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për kryetar të komunës të PDK-së janë vendosur mbi shenjat publike te trafikut , si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 206/2013 më datën 17.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*